



## KOMUNA E PRISHTINËS

### RAPORT

|                     |   |
|---------------------|---|
| Drejtoria           | <b>Drejtoria e Shëndetësisë</b>                                   |
| Periudha Raportuese | <b>Gusht, 2021</b>  |
| Përmes              | Muhamet Pervetica, U.D. i udhëheqësit të Sektorit të shëndetësisë |
| Raportuesi          | Dr. Fatlinda Hoxha, zyrtare për shëndetësi në DSH                 |

#### 1. PËRMBLEDHJE

Përmbledhje e përgjithshme rreth mbarëvajtjes/ecurisë së punës në drejtorinë tuaj për muajin raportues.

Gjatë muajit gusht 2021, Drejtoria e Shëndetësisë pranoi 52 lëndë, të cilat ishin për kategorinë e subvencioneve mjekësore. Stafi në këtë drejtori kishte takime të përditshme me qytetarë, për t'u njoftuar me procedura dhe shërbime sipas interesit dhe kërkesave të tyre.

#### 2. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA

Listoni aktivitetet për muajin raportues, të parapara me planprogramin e Komunës për drejtorinë tuaj:

- Furnizime të ndryshme bazuar në kontratat aktive;

- Monitorimi i mbarëvajtjes së punës në përditshmëri të personelit shëndetësor në QKMF dhe njësitë e saj, si dhe në QMU;
- Inicimi i përgatitjeve administrative, zbatimi i plan-prokurimit 2021;
- Përpilimi i raporteve të ndryshme në kuadër të Drejtorisë.

### 3. AKTIVITETET E IMPLEMENTUARA

Listoni dhe shpjegoni aktivitetet e implementuara gjatë periudhës raportuese nga drejtorja juaj, duke përfshirë edhe aktivitetet që janë në implementim e sipër. Theksoni të arriturat e drejtorisë:

- Realizohet faza e pestë e dezinfektimit hapësinor në komunën e Prishtinës;
- Vazhdimi i testimit të qytetarëve për COVID 19, filluar nga data 20 gusht 2021, me teste rapide në Qendrën e 7-të të Mjekësisë Familjare, në lagjen “Emshir”;
- Anulohen aktivitetet në procedurë prokurimi:
  - Furnizim me vetura për shërbime shëndetësore;
  - Deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike, si dhe rrjetit të kanalizimit në komunën e Prishtinës;
- Njoftohen për dhënien e kontratës aktivitetet:
  - Furnizim me vetura për shërbime shëndetësore;
  - Deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike, si dhe rrjetit të kanalizimit në komunën e Prishtinës;
- Për procedurë ofertimi zhvillohet aktiviteti:
  - Deratizimi i bodrumeve dhe garazheve publike, si dhe rrjetit të kanalizimit në komunën e Prishtinës;
- Caktohet ekipi vlerësuese dhe menaxhues për aktivitetin:
  - Sigurimi fizik për objektet QKMF dhe QMU;
- Raportim në MPB - Të dhënat gjinore, ngritja arsimore e zyrtarëve publikë;
- Zhvillohet aktiviteti - Furnizim dhe montimi i inventarit për objektet KPSH, konkretisht në QMF 5, QMF 4 dhe AMF Bardhosh.

### 4. AKTIVITETET NË IMPLEMENTIM E SIPËR

Të përshkruhen në detaje aktivitetet që janë në implementim e sipër nga drejtorja juaj për muajin raportues:

- Përgatitja e specifikave bazuar në plan-prokurimin 2021;
- Mbikëqyrje e vazhdueshme e punës së përditshme të personelit shëndetësor në objektet shëndetësore rreth mbarëvajtjes së punës;
- Përgatitje teknike rreth vlerësimit të lëndëve të subvencioneve – shëndetësore.

## 5. STATISTIKAT

Të listohen të gjitha statistikat përkatëse për drejtorinë tuaj, duke filluar nga buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese, diskutimet publike, takimet me palë, institucione, qytetarë e të ngjashme, kërkesat për qasje në dokumente zyrtare, lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër, dhe statistika të tjera specifike që mund të ketë drejtoria juaj. Shtoni kategoritë sipas nevojës.

**5.1.1.** Buxheti i planifikuar dhe ai i shpenzuar për periudhën raportuese.

### Raport për muajin gusht, 2021.

| Fondi Burimor       | Planifikuara     | Alokuara     | Shpenzuara | Nr. lëndëve |
|---------------------|------------------|--------------|------------|-------------|
| Pagat               | <b>7,570,000</b> |              |            |             |
| Mallra dhe shërbime | <b>7,570,000</b> | 5,168,624.76 | 560,422.71 |             |
| 10                  | 1,294,300.00     | 970,725.01   | 15,529.20  | 49          |
| 21                  | 400,000.00       |              |            |             |
| 4                   | 771,740.00       | 771,740.00   | 13,488.94  | 31          |
| Komunali            |                  |              |            |             |
|                     | 300,000.00       |              | 15,179.30  | 11          |
| Subvencione         |                  |              |            |             |
|                     | 150,000.00       | 150,000.00   |            |             |
| Kapitale            | 1,211,377.00     |              |            |             |
| 21                  | 1,350,000        | 1,350,000    | 140,081.32 | 4           |
| 22                  | 1,211,377        | 1,211,377    | 39,515.11  | 3           |
| Gjithsej            |                  |              |            | 98          |

## **Aktivitet gjatë muajit gusht**

Raport - deklaram të borxheve më të vjetra se 30 ditë.

Deklarimi për ATK .

Raport mujor i shpenzimeve të realizuara dhe të hyrat nga bashkëpagesat për shërbime shëndetësore.

Pranimi i faturave dhe arkivimi i tyre.

Përgatitja e dokumenteve të nevojshme për procedim të mëtutjeshëm.

Zotimi

Dërgimi i lëndëve për procedim të mëtutjeshëm në financa dhe prokurim.

Përgatitja e deklaratave të disponushemërisë për procedura të prokurimit.

Raport për Ministrinë e Shëndetësisë rreth Fondit të huamarrjes.

### **5.1.2. Takimet me palë**

- Çdo dite nga ora 9:00 - 15:00, DSH bën pranimin e palëve.

### **5.1.3. Takimet me institucione të tjera**

- Drejtoria e Prokurimit:
  - o Procedura rreth kontratave të ndryshme.

### **5.1.4. Diskutime publike/Takimet me qytetarë**

### **5.1.5. Kërkesa për qasje në dokumente zyrtare**

### **5.1.6. Lëndët e pranuar, të kryera dhe në përfundim e sipër**

- 61 lëndë, prej tyre 52 i përkasin trajtimeve mjekësore, ndërsa 9 prej këtyre kërkesave i përkasin kategorisë të ndryshme.

### **5.1.7. Përfitues të subvencioneve:**

### 5.1.8. Takime të tjera

## 6. SFIDAT

Nëse gjatë implementimit të planeve është hasur në vështirësi të ndryshme, p.sh. pengesa brenda Drejtorisë, Komunës apo institucioneve të ndryshme, ju lutëm shpjegoni në këtë hapësirë:

- Mungesa e stafit në DSH;
- Numri jo i mjaftueshëm i stafit shëndetësor, bazuar në nevoja të qytetarëve;
- Buxhet jo i mjaftueshëm, sidomos për kategorinë “Mallra dhe shërbime”, ku me rritjen e numrit të pacientëve dhe shërbimeve, rrezikojmë shërbimet e vazhdueshme deri në fund të vitit.

## 7. AKTIVITETET E PLANIFIKUARA PËR PERIUDHËN PASUESE

- Përgatitjet për publikimet e tenderëve bazuar në planin e prokurimit;
- Monitorim i përditshmërisë së personelit për të ndikuar në shërbime shëndetësore cilësore dhe të qasshme.

## 8. TË TJERA

Shënoni çështjet tjera që mendoni se janë me rëndësi të raportohen e që nuk kanë qenë të përfshira në pikat e mësipërme.

## QENDRA E MJEKËSISË URGJENTE

### Hyrje

Qendra e Mjekësisë Urgjente në Prishtinë gjatë muajit gusht 2021, ofroi shërbime shëndetësore urgjente për qytetarë e Prishtinës dhe fshatrave të komunës së Prishtinës, me ekipe mjekësore dhe autoambulanca.

### Patologjia dhe shërbimet

Nga raportimet e stafit mjekësor, rastet urgjente u trajtuan sipas prioriteteve të urgjencës, nga të cilat dominuan rastet me:

- Hipertension arterial,
- Gastroenterocolitet acute,
- Pneumonitë atipike, susp. COVID 19,
- Ataket ischemike tranzitore;

- Reaksionet alergjike,
- Kokëdhembjet akute,
- Colicat abdominale,
- Diaret të shoqëruara me dehidrime,
- Ataket cerebrovasculare,
- Hipotension,
- Lëndimet nga aksidentet e trafikut,
- Lëndimet aksidentale etj.

Edhe gjatë muajit gusht, nga e hëna deri të shtunën, prej orës 07:00 deri 20:00, një ekip mjekësor nga QMU-ja, ka vazhduar kujdestarit në sallën "1 Tetori" për të ofruar kujdes mjekësor për të gjithë personat që kishin nevojë për tretman dhe këshilla mjekësore.

### **Nga aktivitet kulturo - sportive:**

- Në sheshin "Zahir Pajaziti, ka vazhduar aktiviteti "Akull n'verë", ku përgjatë 1 muaji, filluar nga data 15 korrik deri më 15 gusht një ambulancë me ekip mjekësor ka qëndruar në shesh, me qëllim të ofrimit të ndihmës urgjente qytetarëve në rast nevoje;
- Mbështetje e turnirit futbollistik në periudhën 8 korrik deri me datë 6 gusht 2021, mbajtur në fshatin Hajvali;
- QMU mbështeti edhe ngjarjen ndërkombëtare, organizuar nga Federata Ndërkombëtare e Basketbollit (FIBA) dhe Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK), realizuar në Pallatin e Rinisë, në periudhën 14 deri më 21 gusht 2021;
- Përkrahje profesionale iu ofrua edhe në takimin futbollistik të Superkupës së Kosovës, ndërmjet Prishtinës dhe Llapit, realizuar më 17 gusht 2021;
- Të gjitha pjesëmarrjet e profesionistëve shëndetësorë, së bashku me autoambulanca nga QMU, ishin të miratuara nga menaxhmenti DSH-së.

### **Shërbimet shëndetësore - gusht 2021**

| Nr. | Lloji i shërbimit              | Nr.  |
|-----|--------------------------------|------|
| 1   | Vizita mjekësore në terren     | 1484 |
| 2   | Vizita mjekësore në QMU        | 11   |
| 3   | Shërbimi i kirurgjisë së vogël | 8    |
| 4   | Shërbimi i infermierisë        | 2    |
| 3   | Aksidentet trafiku             | 85   |
| 5   | Fatkeqësitë të tjera           | 42   |
| 6   | EKG                            | 11   |
| 7   | Transport                      | 278  |
| 8   | Konstatim vdekjeje             | 102  |
| 9   | Gjithsej                       | 2032 |

## ZYRA E PROKURIMIT NË QMU

### ❖ AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:

- Zhvillimi i aktiviteteve të procedurave të prokurimit sipas prioriteteve dhe kërkesave nga njësitë kërkuese;
- Bashkëpunimi i Zyrës së prokurimit për kontratat e lidhura në komunë dhe bashkëpunimi sipas UA/2016 të LPP me AQP për kyçje në kontratat e centralizuara;
- Sipas LPB-së, bashkëpunimi me drejtorin e QMU-së për caktimin e komisioneve dhe punimin e vendimeve, nënshkrimi, protokollimi për vlerësimin e ofertave, pranimit të mallrave, shërbimeve, caktimin e menaxhereve të kontratave etj., sipas nevojave të paraqitura.

### ❖ AKTIVITETET E ZBATUARA:

- Nxjerrja e Urdhër blerjeve në sistemin FREE BALANC për të gjitha faturat për kontratat që lidhen në QMU dhe faturat e kontratave të AQP-së të cilat i shfrytëzon QMU-ja;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për furnizim me ujë për pije dhe përgatitja për pagesë;
- Pranimi i faturës dhe dokumenteve tjera përcjellëse për shërbime të fotokopjes dhe printerëve me qira dhe përgatitja për pagesë;
- Pranimi i të gjitha faturave tjera që kanë hyrë në QMU, përgatitja e tyre për pagesë.

### ❖ AKTIVITETET NË ZBATIM E SIPËR:

- Takime me palë të ndryshme, kompletimi i lëndëve për pagesa dhe aktivitete tjera sipas nevojës.

### ❖ AKTIVITETET E PLANIFIKUARA:

- Mbajtja e një takimi me stafin udhëheqës në lidhje me nevojat e domosdoshme për menaxhimin e situatës me virus, kërkesë e stafit mjekësorë.

### ❖ AKTIVITETE TË PËRFUNDUARA:

- Përgatitja e lëndëve të poshtë shënuara për pagesë dhe fotokopjimi i tyre;
- Shpenzimet e telefonit për muajin korrik;
- Shpenzimet e tel. ambulancën në rr. "Xhemail Ibishi" për muajin korrik;
- Mbushje telefonike për punëtorë për muajin korrik;
- Furnizim me ujë për pije për muajin korrik;
- Shfrytëzimi i automjetit me qira për muajin korrik;

- Furnizim me karburante për muajin korrik;
- Përcjellja e pagave me ndryshime – pushime të lehonisë, largime nga puna etj. për muajin korrik;
- Përgatitja e pagave për 3 punëtorët me kontrata për punë specifike, për muajin korrik;
- Përgatitja e formularëve me dokumente përcjellëse për punëtorët e rinj.

❖ **AKTIVITETE NË ZBATIM E SIPER:**

- Faturat të cilat duhet të përgatiten për pagesë;
- Fatura e rrymës;
- Sigurimi i Autoambulancave;
- Mirëmbajtja e fotokopjes me qira dhe printerëve;
- Mbushje telefonike për punëtorët;
- Përgatitja e ndërrimeve të natës;
- Përgatitja e faturave komunal (rrymë ngrohje, PTK) të cilat janë të rregullta, së bashku me faturat e karburanteve dhe automjetit me qira, si dhe pagesat dhe shërbimet tjera.

Kontrollimi i arkës dhe mbarëvajtja e parasë së imët.

**QENDRA KRYESORE E MJEKËSISË FAMILJARE**

**RRJEDHA E PUNËS**

Vazhdon organizimi i brendshëm i përshtatur me situatën epidemiologjike, për ofrimin e shërbimeve shëndetësore:

- Tri Qendra të Mjekësisë Familjare (QKMF, QMF IV dhe QMF V) vazhduan punën pa ndërprerje (24/7) në ndërrime të zakonshme (07:00 - 13:30; 13:30 – 20:00 dhe 19:00 – 07:00);
- Të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare punuan me orar të rregullt (07:00-13:30, 13:30-20:00);
- Në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare është riorganizuar kujdestaria e rregullt mujore, e shtune(07:00-19:00) dhe e diele (07:00-19:00) d.m.th. kalon sikur në ditë të rregullt pune, e organizuar në punë ekipore (d.m.th. të gjitha qendrat të cilat nuk kanë punuar të dielave, prej orës 13:00, tani punojnë deri në ora 19:00;
- Në QMF 7 ka vazhduar të ofrohet edhe testi rapid antigjenik për qytetarët e Prishtinës. Janë punuar 5344 teste, ndërsa në QKMF edhe analiza e D-dimerit, ku janë punuar 821 D-dimerë, që të dyja falas. Po ashtu, janë punuar edhe testet



serologjike, 42 pacientë të testuar me teste serologjik. Pacient për T3, T4, TSH dhe PSA, gjithsej janë 201.

- Numri i konsultave virtuale gjatë muajit gusht ka arritur në 40 konsulta;
- AMF Bardhosh nga data 05.05.2021, është në renovim;
- Poliklinika e Stomatologjisë dhe shërbimi stomatologjik orari i punës(07:00-15:00), shërbimi i stomatologjisë në QMF 5 punon 24/7;
- Shërbimi pediatrik, orari i punës (07:00-13:30 dhe 13:30-20:00);
- QMG, orari i punës (07:00-15:00);
- Shërbimi specialistik, orari i punës (07:00-15:00);
- Mjekësia e punës, orari i punës (07:00-15:00);
- DAT orari i punës (07:00-13:00);
- Laboratori qendror, orari i punës (07:00-14:00 -13:00-20:00);
- Radiologjia, orari i punës (07:00-13:00), tri njësi radiologjike në QKMF, QMF 4, QMF 5;
- Shërbimi i vaksinimit, orari i punës (08:00-16:00), orari është përshtatur për arsye se pjesa më e madhe e punëtorëve shëndetësorë nga data 29.03.2021, janë duke kontribuar në sallën "1 TETORI" rreth vaksinimit të qytetarëve kundër COVID 19, kemi 8 ekipe të përbëra nga mjekë dhe infermierë, gjithsej 26 punëtorë nga QKMF dhe ekipet mbështetëse nga MSH;
- Numri i stafit të infektuar gjatë muajit gusht, 25 punëtorë shëndetësorë të infektuar. Gjatë vizitave monitoruese në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare (ndërrimi i paradites, pasdites dhe ndërrimi i natës) nuk janë konstatuar mangësi serioze.
  - Respektohen rregullat e përgjithshme, furnizimi qëndron mirë, masat mbrojtëse aplikohen.
    - Numri i vizitave mjekësore në të gjitha Qendrat e Mjekësisë Familjare - Prishtinë, 52.604 vizita mjekësore;
    - Numri i infuzioneve për pacientët COVID 19 pozitiv - 5.835;
    - Numri i infuzioneve tjera - 7.324;
    - Numri i injeksioneve - 7.467;
    - Numri i pastrimit të plagëve - 4.283;
    - Ndërrimi i natës (QKMF, QMF IV, QMF V ) nga data 02.08.2021-29.08.2021. Numri i vizitave mjekësore 8.109 , infuzioneve për pacientët COVID 19 pozitiv - 559, infuzione të tjera - 1.072, numri i injeksioneve - 1.994, i pastrimit të plagëve 129.

Numri total i të gjitha vizitave mjekësore - 60.713, numri i infuzioneve për pacientët COVID 19 pozitiv - 6.394 , numri i infuzioneve të tjera - 8.396, numri i injeksioneve - 9.461 dhe numri i pastrimit të plagëve - 4.412.

| Vizita mjekësore | Shërbimet shëndetësore | Shërbimet laboratorike | Shërbimet stomatologjike | Shërbimet radiologjike | Gjithsej |
|------------------|------------------------|------------------------|--------------------------|------------------------|----------|
| 92088            | 81838                  | 83334                  | 10430                    | 2539                   | 270229   |